



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije-Ministry of Finance  
Agjencia Qendrore e Prokurimit/Centralna Agjencia Nabavka / Central Procurement Agency

Datë/A:	16 .02.2015
Për/Za/To:	Autoritetet Kontraktuese
CC:	Komisionit Rregullativ te Prokurimit Publik (KRPP)
Nga/Od/From:	Mursel Racaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
Tema/Subjekat/Subjekt:	Informim lidhur me zhvillimin e Prokurimeve Qendrore

Të nderuar,

Ju informojmë se Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 02.02.2015, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, neni 95 pika 2 ka dorëzuar listën e artikujve të përdorimit të përbashkët për Prokurime Qendrore për vitin fiskal 2015 në Ministrinë e Financave. Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Financave, në mbledhjen e saj të fundit ka aprovuar Udhezimin Administrativ për artikujt e përdorimit të përbashkët, prokurimi i të cilave i është caktuar AQP-së. Autoritetet Kontraktuese që gjenden në listën e publikuar në uebfaqen e KRPP-së ([www.krpp.rks-gov.net](http://www.krpp.rks-gov.net)) dhe në uebfaqen e AQP-së ([www.aqp.rks-gov.net](http://www.aqp.rks-gov.net)) nuk mund të zhvillojnë prokurimet për artikujt e listës së aprovuar nga Qeveria e Kosovës sipas nenit 95, paragrafi 2 i Ligjit Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 .

**Lista e artikujve për përdorim të përbashkët që është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës:**

**1. Derivatet**

- 1.1. Derivatet e lëngshme (benzinë për automjete, naftë për automjete, naftë për makina, mazut);
- 1.2. Derivatet e ngurta (thëngjill, dru, pelet prej druri);

**2. Material për zyre**

- 2.1. Letër për kopje dhe produkte të tjera të letrës;
- 2.2. Furnizim me material shpenzues për zyrë.

**3. Produkte higjienike**

- 3.1. Material për pastrim, vegla dhe agjentë;
- 3.2. Shërbime të pastrimit.

**4. Prokurimi i ushqimit**

- 4.1. Produktet e ushqimit;
- 4.2. Shërbimet për dispozitat e ushqimit.
- 5. Furnizim me bileta**
- 5.1. Furnizim me bileta të aeroplanit
- 6. Furnizim me goma**
- 6.1. Furnizim me goma

Autoritetet Kontraktuese në ditët në vijim do të kontaktohen nga AQP-ja me qëllim që ti dorëzojnë planifikimet e prokurimit me detajishtë vetëm për artikujtë e listës së aprovuar nga Qeveria. Artikujtë e përdorimit të përbashkët duhet të shoqërohen me specifikime të detajuara dhe të parashihen për tri vitet e ardhshme si: sasi të përafërta vjetore dhe vlera e parashikuar. Detajet tjera do të kërkohen nga Autoritetet Kontraktuese në ditët në vijim.

Me respekt